

GASPËR K. PALI

BjH-1

1919

20  
5  
95-98

23

95-98

HYJT MBI GREMINË

85H-1

P 18

GASPËR K. PALI

(Gimi)

~~25688~~

14054  
BIBLIOTEKA E SHËTETIT  
GJIRDHASTËR

~~8A-1~~

~~201 24~~

# HYJT MBI GREMINË

*Vjersha*

*Mbledhur dhe redaktuar nga Nasho Jorgaqi  
dhe Filip Ndocaj*

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»

TIRANË, 1959



**GASPËR K. PALI**

---

## GASPËR PALI

(1916 - 1942)

Gaspër Pali është një nga ata autorë që hyjnë, siç është bërë zakon të thuhet, në grupin e «shkrimtarëve të vdekur». Këta autorë, nga të cilët mund të përmendim Veli Stafën, Helenaun e Gaspër Palin, nuk i bashkon vetëm fakti se vdiqën që të tre parakohe, por edhe pse kanë shumë anë të përbashkëta në jetën e tyre të shkurtër dhe në trashëgimin letrar që na kanë lënë. Ata, që të tre pothuajse fëmininë e rininë e parë e kaluan në Shkodër, që të tre shkuan jashtë për të vazhduar studimet e larta, që të tre vuajtën nga tuberkulozi, e që të tre e ndërprejnë para kohe rrugën e jetës e të letërsisë. Ata krijuan në periudhën e letërsisë së independencës, qenë të përparuar në jetë e në letërsi, u tërhoqën e u frymëzuan nga aspekte të përbashkëta të jetës shqiptare, trajtuan pothuajse një tematikë dhe iu afruan njeri tjetrit, kush më shumë e kush më pak në mënyrat e tyre letrare.

Gaspër Pali, që bën pjesë në grupin e «shkrimtarëve të vdekur», të cilët kanë hyrë tashmë në historinë e letërsisë sonë, mbart karakteristikat e këtij grupi, por ruan dhe veçoritë e tija që duhen

studjuar, pa dyshim, më vete. Autori i këtyre rradhëve e ka pasur vështirë për t'u njohur me jetën dhe veprën e Gaspër Palit, mbasi mbi poetin mungojnë studimet më elementare dhe trashëgimi i tij letrar është akoma i shpërndarë.

Gaspër Pali lindi në Shkodër, me 14 gusht 1916 në familjen e një tregëtari që sa vintë e binte më poshtë. Ishte i njëmbëdhjeti fëmijë i kësaj familjeje. Mbasi mbaron shkollën fillore të françeskanëve me përfundime shumë të mira, vazhdon gjimnazin e shtetit të Shkodrës në degën klasike, të cilën e kryen me sukses më 1935.

Duke qenë akoma nxënës në shkollën e mesme ai arriti të zotrojë veç gjuhëve klasike, greqishtes së vjetër dhe latinishtes edhe italishten e gjermanishten. Zotrimi i këtyre gjuhëve e ndihmoi mjaft poetin të njihet me letërsinë e madhe botërore. Kështu ai lexoi n'origjinal Homerin dhe Virgjilin, Aristofanin dhe Plautin, Horacin dhe Ovidin. Më vonë ai jepet i tëri pas leximit të letërsisë moderne, pas V. Hugoit, H. Haines, V. Gëtes, F. Shilerit, O. Balzakut, J. Turgenievit, Dostojevskit, A. Çehovit. Me sa dëshmojnë shokët e tij, poeti në vitet e fundit lexonte me dëshirë të madhe vepra të letërsisë sovjetike të përkthyer në italisht. Atij i pëlqente veçanërisht Gorki, Shollohovi, Leonovi dhe Sejfulina. Poeti, me gjithëse pati përpara gjithë thesarin e letërsisë së përbotëshme, ai nuk la pas dore letërsinë shqipe dhe folklorin tonë të pasur. Nga shkrimtarët tanë ai kish për zemër Naimin, Mjedën dhe sidomos Seremben, të cilit i ngjau me spontaneitetin dhe lirizmin e tij të hollë.

Mbasi mbaroi gjimnazin, ai ngeli për afro një vit e gjysëm pa punë sepse nuk iu dha bursë shtet-

nore dhe se vetë nuk ishte në gjendje ekonomike t'i vazhdonte studimet e larta. Gjatë kësaj periudhe ai u njoh me realitetin e hidhur dhe provoi se ç'do të thotë të jeshë i papunë. Me përpjekje dhe vësh-tirësi të mëdha, ai mundi të regjistrohet në fakul-tetin e letërsisë të Universitetit të Firences. Vitet e studimeve të larta qenë për poetin vite priva-cionesh ekonomike, fizike dhe shpirtërore. Ndofta këto vite të vështira bënë që sëmundja të përparojë shumë dhe e çuan atë shpejt në varr. Më në fund, në vitin 1940 ai i mbaroi studimet dhe u lauria në letërsi duke mbrojtur tezën «Depërtimi romak në Shqipëri». Me diplomën në xhep, mbas kaqë vjetë studimesh, poeti u kthye në vëndlindje, ku u emrua si profesor i letërsisë në Liceun e Shtetit. Gjatë ko-hës së shkurtër që ai shërbeu atje u çqua në punën e tij si mësonjës dhe si njeri. Ai u nderua dhe u çmua nga kolegët dhe nxënësit e tij, për kulturën e gjërë le-trare, për thjeshtësinë, për talentin dhe për simpathi-në që kish ndaj lëvizjes Nacional Çlirimtare. Por mëso-njësi dhe poeti me talent që u respektua aq shumë nga nxënësit dhe shokët, nuk e pati të gjatë në pu-në. Ai prej kohësh vuante nga tuberkulozi dhe fiziku i tij i dobët nuk i bëri ballë sëmundjes që e kish marrë për keq. Më 21 korrik të vitit 1942, pothuajse dy vjet mbasi kish filluar nga detyra si mësonjës, vdiq në moshën 26 vjeçare. Ja se çfarë shkruan një ish nxë-nës i tij për vdekjen e poetit:

«Në një mëngjes vere, një dorë e fortë trokiti në derën e shtëpisë sime. Dal: Ishte një shok i imi. Në fytyrën e tij dallova shpejt një dhimbje të ma-dhe.

— Profesor Gaspër Pali ka vdekë! — tha tue më shtrëngue dorën. Lajmo nër shokë.

Kishte vdekë një puntuer i letravet shqipe.  
Kishte pushue së rrahuri një zemër që kishte vuejtë  
të thellë jetën!... Ishte zhdukë mësuesi i im!

E mue m'u lidh, këtu te fyti diçka si ny».

Siç shihet, poeti vdiq fare i ri duke pësuar  
kështu fatin e shokëve të tij që e lanë para kohe,  
fatin e Helenaut, Migjenit, Platonikusit.

Gaspër Pali e ndërpreu rrugën letrare në lulezim  
e forcave të tij krijonjëse, në kohën kur me lëvizjen  
nacional çlirimtare dhe me përpjekjet që bënte vetë  
poeti, po i hapeshin perspektiva popullore dhe intelektualëve  
patriotë.

Ai nuk prodhoi shumë, pse edhe jetoi pak. Gjithësejt  
na la njëzet e katër poezi, dy novela, të botuara njëra  
me subjekt nga historia e jonë e lashtë, e tjetra me temë  
folklorike, dhe afro njëzet proza në dorëshkrim, të cilat  
s'i njohim nga afër, dhe disa artikuj kritikë që s'kanë  
ndonjë interes të veçantë. Ëndra e poetit ish ta përmbledhte  
prodhimin e tij poetik në një vëllim. Për këtë edhe punoi  
që kur ishte gjallë. Ai mblodhi gjashtëmbëdhjetë lirikat  
e tij më të mira nën titullin «Bisedë në vetvedin», i  
redaktoi dhe ja la familjes e shokëve të tij. Trashëgimi  
që na ka lënë dhe posaçërisht vjershat, dëshmojnë për  
talentin e vërtetë të autorit. Ato rrëfejnë se ai ka qenë  
një poet me frymëzim e herë-herë me hove spontane;  
një poet me ndjeshmëri artistike të zhvilluar. Këto  
cilësi të personalitetit të tij letrar dhe disa nga  
vjershat e tij më të shëndosha e bëjnë Gaspër Palin  
një autor që ka sjellë një kontribut në zhvillimin e  
poezisë shqipe pas rilindjes. Gaspër Pali që fare i ri  
u dha mbas letërsisë dhe folklorit. Kur ish në bangat  
e shkollës, ai u muarr me lexime dhe u tërhoq nga  
natyra e bu-

kur e qytetit të lindjes. Kjo periudhë do të influen-  
cojë shumë në prodhimet e para. Ai filloi të shkruajë  
që kur ish akoma nxënës, në vitet 1931-1932. Vjer-  
sha e parë që njohim është soneti «Cordium donum»,  
një vjershë e errët kushtuar jetës shkollore. Pastaj  
vjen vjersha «Tingëllim» një hymn kushtuar Apo-  
llit, perëndisë klasike të diellit që mban jetën mbi  
tokë dhe që lidh gëzimin e poetit me atë të botës  
mbarë.

Poezia «Djepi i vorfën» është i pari krijim i  
poetit të ri në fillimin e krijimtarisë së tij që ka  
një motiv të qartë. Këtu ai na jep imazhin e mje-  
rimit, një pamje konkrete nga jeta: një nënë që lyp  
e uritur dhe zveshur me foshnjen e saj në krah që  
qesh. Antiteza që është vënë në bazën e kësaj vjer-  
she të prek e, veçanërisht mbyllja kur thotë:

«Nën mjerime ç'se ke le  
bir, ke ndeshë!»  
Shpërthen n'fshamë grueja e re  
foshnja qeshë.

Pas këtyre vjershave, që janë provat e para  
të poetit, dhe ai s'i botoi, ne mund të radhitim vjer-  
shat që i përkasin një faze më të pjekur si elegjia  
«Mëngjez Shnjergjash», vjersha «Bisedë me vet-  
vetin», idili i bukur, «Natë shtregllash». Poezia  
«Bisedë me qytetin tim», të cilin poeti sa që gjallë  
nuk e botoi, është shkruar me vargje të lira dhe  
evokon lavdinë e dikurshme të Shkodrës, e veçanë-  
risht të Rozafës, që tashti, simbas poetit e kanë  
mbuluar gërmadhat. Mbas disa vargjeve të mje-  
gullta e pesimiste, vjersha mbyllet me këtë mendim  
të shëndoshë:



Por Shkodra prap andrron  
e zemra nuk e lshon  
Dhe mue m'dridhet një shpresë  
Si n'zembrën tande.  
Kshtu mjes mjerimi na buron andrrimi  
pse ty e mue, Shkodër, me andrrue na kande.

Vjersha e parë e botuar e Gaspër Palit mban titullin «Natë shtregllash». Këtë vjershë ai e botoi në një nga numurat e revistës «Rilindja» më 1936. Është një poezi e ndjerë, në të cilën poeti kujton një nga zakonet e qytetit të lindjes, një natë shtregllash, kur të rinjt' e të rejat dëfrehen në prani të pleqve që «mbesin shtang» «... n'sa përkujtojnë të dikurshmet stinë kalue me lojë dhe t'ambula valle».

Ai qe një poet me egzigjenca artistike. Pali punoi me limë në dorë. Ai i përpunonte vazhdimisht vjershat e tij. Mjafton të themi se vjershën «Andrrime fjorentine» e kemi në katër variante.

Por Gaspër Pali qe njeri i pa kënaqur nga jeta, nga bota që e rrethonte, nga vetja dhe nuk gjeti forca ta përqafojë të vërtetën të cilën e kërkoi pa reshtur.

Gaspër Pali për vetë karakterin e poezisë së tij, është kryesisht poet lirik me një notë origjinale. Themi se është poet lirik sepse i gjithë trashëgimi i tij poetik këtë rrëfen, këtë rrëfen tematika, këtë e rrëfen mënyra origjinale e të shtjelluarit të subjektit, këtë e dëshmon frymëzimi i ngrohtë dhe vargu i lirë që i përgjigjet më mirë dufeve të poetit. Vjershat e tij janë, siç i shkruan poeti një shokut në një letër «pasqyrë e shpirtit...». Kjo e shpjegon deri diku edhe faktin pse lirika e Palit është shpesh herë thellësisht subjektive. Tematika e prodhimit të tij

poetik është në përgjithësi e ngushtë. Në vjershat që na ka lënë, kemi më shumë përshtypje e kujtime lirike, se sa aspekte të marra nga jeta e gjallë me një qëllim të caktuar. Ai është akoma larg nga problematika shoqërore. Në disa vjersha gjejmë indirekt vetëm jehonën e ngjarjeve të mëdha të kohës dhe jo vetë ngjarjet.

Por ajo që ndjehet në çdo poezi të Gaspër Pallit është çqetësimi i poetit, pakënaqësia e tij ndaj jetës, ndaj kohës, përpjekja e tij për të gjetur diçka më të mirë e më të pastër. Ai e kuptonte se motivet personale të vjershave të tij, mungesa e perspektivës, paqartësia ideologjike e kishin futur në një qorrsokak ose siç thotë vetë «udhash të vetmueme». Prandaj poeti thërret me sinqeritet:

«... Dritë dëshroj  
për me njohtë shtigjet, që jam kah përshkoj!..»

Ky pësjtjellim në botën e poetit e në të njëjtën kohë dëshira e tij për të gjetur të vërtetën ka arsye sociale dhe arsye të tjera që lidhen direkt me jetën personale të tij. Ai krijoi në një kohë kur në jetën tonë kulturele egzistonte një konfuzion i math ideologjik, kur në letërsinë tonë kishin hyrë izma të ndryshme t'importuara nga jashtë, kur intelektualët tanë ishin ende larg nga e vërteta. Pastaj nuk duhet të lëmë pa përmendur influencën negative të disa autorëve të letërsisë moderne italiane, ndikimin e keq që poeti pati nga pesimizmi Dostojevskit, Leopardit, dhe Ualdit; shkëputja e tij nga jeta, temperamenti i mbyllur dhe sëmundja që nuk iu ndanë gjatë gjithë jetës.

Këtu duhet të gjejmë shkakun e pesimizmit të poetit dhe të paqartësisë ideore.

Të gjitha vjershat që kemi në dorë i përkasin viteve të fundit të regjimit zogist e fillimit t'okupimit fashist. Ai punoi afërsisht nga viti 1935 deri më 1942, periudhë kjo e mbushur me ngjarje sidomos me ato të luftës së dytë botërore. Lufta dhe pasojat e saj të rënda për popujt e për kulturën — ja se ç'e shqetëson poetin në disa poezi. Kur ishte në Firence ai shkruan vjershën «Hyjt mbi greminë» ku flet i tronditur për të këqiat e luftës:

«Hijet m'murmurojnë:

Ende vallet s'të janë shuemë?»

O si t'kndon zemra — m'pyesin një zani

n'sa n'botë s'ndihet veç vaj,

e nga gjokset tonë, gjaku derdhet rrkajë!

E m'tronditet shpirti e shduken kangë nga buzë x

Karakteristike për ato që thamë më lart është veçanërisht vjersha «Pranë luftës», në të cilën poeti nuk nxjerr vetëm çqetësimin, që e ka zënë atë vetë, por edhe çqetësimin e popullit, i cili pëson tmerret e luftës. Këtë e jep me anë të një skene ku gratë pyesin me frikë në zemër poetin për fatin e luftës dhe poeti nuk di ç'tu thotë, veçse fillon e fillozofon me vetveten:

«Ka fillue lufta

sepse nga zjarmi i vjetër

n'zemrat njerzore veç hi ka mbetë,

si rrenojet n'qytete mijëvjeçare.

E tash një flakë tjetër

kërkojnë shpirtent të dishruem për dritë».

Poeti herë pas here kthehet në historinë tonë të lashtë dhe flet me respekt e krenari për ilirët.

të parët tanë. Evokimi i së kaluarës së largët, dhe vënia përball kësaj e kohës kur jetonte poeti tregojnë pakënaqësinë që kish ai ndaj realitetit që s'i përgjigjej aspiratave e shpresave të tij. Duke pikaturuar një natë shtregllash, poeti gjen rast të hidhet në një digresion lirik që ka të bëjë me kohën iliriane:

Shpërndahen dridhje, në të vëndit tonë hapsinë.  
Ilire kodra, të reja Ilire ndjejn  
e shtreglla e valle të hershme  
Teuta që këndoi dikur,  
tue këndue varzat e ndershme  
të qytetit të Shkodrës, që nuk flen der vonë,  
tue pritë në valle si gjithmonë.

Një nga motivet më të preferuar të poetit është ai i vendlindjes. Shkodra, si djep i kujtimeve të fëminisë e rinisë së poetit, Shkodra dëshmitare e ngjarjeve të mëdha historike, Shkodra vënd i natyrës së bukur dhe i zakoneve shqiptare — ja se ç'del në vjershat «Natë shkodrane», «Bisedë me qytetin tim» e në të tjera të këtij lloji.

Disa nga vjershat e shkruara në dhe të huaj si «Andrime fiorentine», «Muzg fjorentin», «Vëgim mërgimesh» përshkohen nga malli i zjarrtë për vendlindjen. Poetin, kur kujton Shkodrën, e kap një nostalgji e thellë që i zgjon kujtime e ëndërrime të paharruara:

M'shpirt tim

Rreh malli i Shkodrës. Tash, që jam n'mërgim,  
kam et netësh shqiptare.

Pse më kujtohen mbramjet magjistare  
ku çdo jeh në muzg vdes ashtu meiherë,  
në t'amblen heshti.

Duke qenë larg atdheut, i mbërthyer nga malli dhe kujtimet e Shkodrës, poeti kërkon të vajtojë si bilbili («Muzg fjorentin») e nga ç'ë s'mundet fillon e bie në pesimizëm:

Syni i jem s'pranë tue kërkue,  
hyllin, por, s'mundet me e gjetë -  
E n'shpirtin tim, tallazi, më kërcnon  
n'sa bilbili posht vajton.

Ndryshe ngjet me poetin në vjershën «Hyjt mbi greminë» ku nuk kërkon të vajtojë si bilbili, por do që të këndojë, se simbas tij, poezia të ngjallë e të jep jetë. Kështu e kupton ai rolin e poezisë:

«Prandej me kangë dëshroj me shërue plagët  
kanga m'ngjallë rininë,  
pse vargjet lënojnë dhimat...»

Në një rradhë vjershash poeti hymnizon vashën, takimet, netët e qarta me hënë, psherëtimat e kujtimet. Ai i këndon një dashurie të singertë dhe ideale, një dashurie të pastër që nuk njeh veçse pshertima e vështrime të magjishme. Pjesa më e madhe e këtyre vjershave janë pesimiste e herëherë mistike e të mjegullta që e vështirësojnë kuptimin. Por prap në to ka vargje të goditura që karakterizojnë situata të ndryshme të poetit të dashuruar.

Ja si e ëndërron poeti vajzën e tij në vjershën «Zanë stuhish»:

Androva një vashë  
me sy, si dy copë qielle  
e me buzë t'njoma, që s'dijnë veç me dasht;

*Ka raste kur poetit dashunia për vajzën i zgjon energji të reja dhe e ndihmon në jetë, siç thotë në vjershën «Vashë e pa njohtun»:*

Kështu vashë,  
fytyra e jote forca t'reja m'ngjallë  
pse m'bahet se vrej misterin mu n'ballë.

*Gaspër Pali, me gjithëse na ka lënë një trashëgim modest, prap se prap ajo tufë vjershash rrëfen shumë për talentin e sigurtë të poetit të ri. Ai ish një poet me sentimente të holla, delikate që din-te të spikaste momente interesante e t'i ngrinte n'art. Kështu shpjegohet që kriteret në kapjen e momenteve, në zgjidhjen e tematikës nuk qenë gjithmonë të shëndosha. Motivet e lirikës së tij rrallë dalin nga kuadri personal. Poeti pak i ka vënë veshin kohës, pak ose hiç dalin në vepër problemet e kohës, pak del realiteti i hidhur që e çqetësonte aqë shumë atë. . . Por poeti që kish një zemër të pastër e një sensibilitet të hollë e ndjente këtë dhe bënte ç'ishte e mundur për të dalë nga «tisi i vegimeve të krijueme». Kjo luftë e ashpër psikologjike që zhvillohet në botën e trazuar të poetit pasqyrohet në vjershën e tij më të shëndoshë që mban titullin kuptimplotë: «Prendimi i andrimeve». Këtu ai përfundon me këto vargje:*

«Zani m'grishë me jetue  
e jo me afrue qepallën me qepallë  
e me ndej tue andrrue,  
më thotë zani: me i kndue jetës  
më thotë zani: me i kndue kohës  
më thotë zani: kndoj s'vërtetës.

Por poeti nuk pati kohë ta vejë në jetë këtë program pozitiv. Ai vdiq i ri dhe s'mundi t'i kristalizojë disa nga idetë e tij të shëndosha. Veç përpjekja e tij për t'u vënë në një rrugë më të drejtë, dëshira e tij për t'i kënduar jetës e së vërtetës, kërkimet e tij të vazhdueshme për diçka më të mirë e më të pastër, pakënaqësia ndaj kohës, aspiratat e tij humane, ndonëse disa herë jo të qarta dhe më në fund talenti i tij poetik që shkëlqeu në një radhë vjershash — të gjitha këto e bëjnë Gaspër Palin një autor që meriton të lexohet e të studjohet.

Duke botuar këtë tubë vjershash, ne kontribuojmë për njohjen e Gaspër Palit si poet në masën e lexuesve dhe njëkohësisht çojmë në vend dëshirën që ai pat sa që gjallë për t'i parë vjershat të përmbledhura në një vëllim.

NASHO JORGAQI

## ZEMER ANDËRRTARE

**P**ershkova, veshë n'zhgun 1) t'murrmë, pylla 2)  
t'blerueshme,  
ku prej çdo gjethi, nga një kangë burote.  
Kndojshem dhe vetë, bashkue me karvanë t'gzu-  
eshme  
n'udhë që s'mbarote:

«Qofshi bekue, ju bilbilat e malit  
e motrat deve, që s'din ç'asht ankimi.  
E qofsh bekue, lum, që rrrshqet mbi shpinë t'zallit  
e ftofë gojën time.»

E kanga e jeme, dridhej n'veshë t'udhtarve  
e u qeshte ftyra, si qiella n'prendverë.  
E kupen time, njani prej udhtarve,  
mbushte përherë.

---

1) zhgun-i = rrobë që veshin murgët.  
2) pylla = pyje.



Por u zhduk andrra, si n't'hapsinës qiellë  
tymtaja <sup>1)</sup> e nji kamini <sup>2)</sup> t'vogël tretë.  
Un mblova syt, se andrra, që zu fillë  
deshi me m' mbetë.

Shkodër 1939.

---

1) Tymtaj-a = mjegullë e hollë që ndehet anash syno-  
rit muzgjeve.

2) Kamin-i = pjesa e sipërme e oxhakut që del mbi  
pullaz.

---

## BISEDË ME QYTETIN TIM

**D**ikur vallzimi  
nuk mete <sup>1)</sup> një herë,  
në Rozafën mijvjeçare.  
Si vegim endej mbarë jeta  
në Shkodrën andërrtare.  
Por një t'dridhun qepallash  
ngjatë lumnija n'botë.  
Kështu gazi n'qytet tem u shue  
e mbi buzë t'mija t'shkreta.  
Sepse sa u zhduk rinia,  
një nga një u tretën tana shpres't e mia.

Sot n'Rozafë gërmadhat kan' bulue,  
e n'shpiert tem ka zbritë trishtimi.  
E dita e nata s'ka kurrnjë ndryshim,  
pse jeta nuk falë jetë  
e nata s'falë pushim.

---

1) me mejtë, nuk mete = me pushue, nuk pushonte.

N'muzg ndezet drita e mjerë,  
jo si dikur n'kangë natën me e kalue,  
pse tash menë vallet, që u knduen njiherë.  
E s'duken shpresë nër sy mertisë n'trishtim<sup>1)</sup>  
e nuk lindë gaz nër votra pa zjarm mbetë.  
Mbrendë në shtëpia dridhet veç ankim  
e der jashtë qejt hungrojnë  
e n'ajri si gjamë ushtojnë.

Por Shkodra prap andrron  
e zemra nuk e lshon.  
Dhe mue m'dridhet një shpresë.  
si n'zemren tande.  
Kështu mjes mjerimi na buron andrrimi  
pse ty e mue, Shkodër, me andrrue na kande.

Shkodër 1935. —

---

1) sy mertisë n'trishtim = sy mbuluar me trishtim.

---

## NATË SHKODRANE

**N**'hije kumblat janë zhdukë,  
veç ndihet frushullimi. 1)  
E mbarë qyteti e (mali) n'terr asht strukë.  
Pa pritë del hana  
si shpërthen boça, 2) sa t'dridhet agimi.  
E mali hijesh sdeshet. 3)  
T'purpurt pullaze shndrisin  
e shoh tash kumblat n'kopshte, që s'pashë ma parë.  
Gjethi me gjethin përmbi tokë qëndisin,  
nji rrexe 4) me hije e dritë.

---

1) Frushullimi = fëshfëritja e gjetheve.

2) boçe = një lloj lule që lulëzon në kënetë me të  
hindur të diellit dhe mbyllet në perëndim (nympha).

3) sdeshet = çvishet.

4) rrexe = tantellë.


Zhurmat e ditës,  
nji nga nji heshtin, gadi pa u kujtue  
e shuhen, si dihatjet në shtrat të vdekjes.  
Porse nga s'largu, zana vijn tu' u shtue.  
Bretkocat, n'livadhe  
në fund t'qytetit, dehen n'dritë të hanës  
e dridhin gushat.  
E kangën der këtu e hjedhë nji e lehtë erë:  
e m'duken valle shrrregllash në prendverë.

Shkodër qofsh levdue,  
nga buz't e vashës s're si karajfili!  
Pse netët e ambla, vasha din me i kndue.

1940

---

## VJESHTË

iella u turbullue  
si syni i vash's, që qanë dashtnin ma t'parë.  
E retë nisen me u shtue.  
Atherë dalldyshat,  
me za plot trishtim,  
njana tjetrën lajmuen m'u nisë n'mërgim.  
Prej çerdheve nën pullaze,  
dalldyshet dolen;  
e para se m'u nisë,  
n'qytet anë m'anë u sullen.  
Nga mali tash sa sbardhë,  
filloi një gjamë me ardhë,  
murlani fryen.

E gjeth't s'ka shum verdhue,  
dridhen, si të vogjlit fmi që n'derë troklojnë 1)  
e për nji koje buke 2), shpinë urojnë —  
por era pa pra,  
filizat tue përshkue  
gjethin prej gjethit don me forcë me e da.

1939

---

1) Traklojnë = trokasin.

2) koje buke = korë buke.

---

## DJEPI I VORFËN

**M**e furi fryn e flokon 1)  
pa ja da.  
Fmia n'djep dy syt i sblon 2)  
e s'flen ma.

Përkund djepin dal'kadalë  
grueja e zbetë;  
ftofti i madh të voglin djalë 3)  
s'len me fjetë.

Foshnja kjan e nana kndon  
me butsi:  
«Qyshë në djep, bir, po fillon  
me hjekë zi».

- 
- 1) flokon = bize borë flokë-flokë — shuka-shuka.  
2) Syt' i sblon = sytë hap.  
3) Përbri këtij vargu, gjendet një varjant tjetër;  
«por murrani t'voglin djalë»



Po bjen borë e s'len me shkue  
në të hueja dyerë;  
n'odë, qi gja nuk ka teprue,<sup>1)</sup>  
pa shpresë kqyrë.

«Nër mjerime, ç'se ke le,  
bir, ke ndeshë!»  
Shpërthen në fshame grueja e re,  
foshnja qeshë.

---

1) Përmbrij këtij vargu e tjetrit që ndjek, ka dy vargje të tjerë si varjante:

«Nana e ngratë nisë me lotue  
krah fmin kqyrë.»

## KANGË GUNGALLASH

**H**eshtë zhurma e karros n'udhën vetmitare.  
Heshtin zajet <sup>1)</sup> djaloshare.  
Fmit s'shkrryehen mb' dhe t'zharitun <sup>2)</sup>.  
Heshtë krizma  
që nep kova n'pus tue zbritun.  
Cijimi <sup>3)</sup> heshtë.  
E ndalet udhëtari n'hije t'shpeshtë.  
E çdo qytetar  
asht lshue n'krahët e gjumit andërrtar.  
Por gungalla <sup>4)</sup> nuk pushon,  
por gungalla kndon.  
Nga kumblla n'kumbull dridhin  
ajrin e djegun nga rreze djellore  
e janë të vetmet jone,  
që përkujtojnë jetën n'zhegjet verore.

---

1) zajet = shumësi i fj. za. zani-zajet = zërat.

2) i zharitun = i djegun, i përvëluar.

3) Cijimi = fjalë onomatopeike, këtu për gërvishtjen e çikrikut.

4) gungalla = gjinkalla.

Dhe mue qepallat m'rrahin  
e mbi sye  
donë t'm'ndehen terrina 1).  
Por unë ty t'dëgjoj o gungallë.  
E kanga e jote m'ngjallë  
njimij' andrrime.  
E fjala e jote m'përkundë në kujtime  
e m'ban me mendue.  
Si kanga e jote asht edhe kanga e ime.  
Prandaj largoj shpejt gjumin nga qepallat  
e t'qasem me dëgjue.

**Shkodër 1939.**

---

1) terrina = errësira.

---

## VEGIM MËRGIMESH

**N**'shpirtin tim  
rreh malli i Shkodrës. Tash, që jam n'mërgim,  
kam et 1) netësh shqiptare.  
Pse më përkujtohen mbramjet magjistare  
ku çdo jeh 2) në muzg, vdes ashtu meiherë  
në t'ablën heshti.  
Ndiej frushullim gjethesh  
kah përkdhelë pema pemën me butsi.  
Por kur mbas mali zblon ballin e gjanë  
hana fytyrëbardhë.  
zana shpërthejnë.  
Tash s'ndjej land't tue pëshperitë,  
pse hana qiejt nga gjumi trazon  
e njimij' gojë lehin ashtu pa pritë.

---

1) et = etje.

2) jeh = jehonë.

E vashat ledhatare  
qeshin kah ngrehin shtregullat mijvjeçare.

Përkundë djali e kndon:

«Po ti hanë, pse s'dole mbramë?»

Vasha sheh syt djalosharë,  
që qeshen n't'mekten dritë:

«Mbramë, si ti dhe un o djalë,  
hanën kam pritë».

Por nuk ngjati shumë vegimi andërrtar.

Zhdukë andrra, n'shpirtin tim

mali kthen meisherë,

mbasi kërkush nuk kndon për mue n'mërgim.

---

## MUZG MËRGIMI

**M**bi syt t'lodhun, dalngadalë,  
nji tymtajë ndehet.  
Në dhomë nga çdo anë,  
hije burojnë e qasen me hap t'ploshtë<sup>1)</sup>.  
Dielli ka mshehë ballin e gjanë.  
E poshtë,  
i njellë,<sup>2)</sup> zogu zogut, gjumë.  
Hije t'hjellta<sup>3)</sup> si selvi,  
më murmurojnë:  
— Shkëputi syt'e librat treti.  
N'ara dil, si dikur fmi. —  
E si n'dhomë hijet u ngjallën,  
fantazmat murmuritse  
njimij' kujtime nga fminia m'falen:  
— Muzgjet plot kumbonë  
kur ngitshim arash të mblueme nga tymtaja,  
n'sa n'qiellë, si syni i jonë,  
lshojshim balona. —

---

1) T'ploshtë = të plogësht.

2) i njellë = i ndjellë.

3) hije t'hjellta = hije të gjata e të holla.

Andrrimet tona,  
kaloshin përtej malit.  
E kur dilte hana,  
na fmi prej zallit,  
balonën, der'hanë, dojshim me e çue.  
Sonte, n'sa hijet m'flasin  
kërkoj han'n m'e ndesh përsri.  
Por hana, ma nuk m'qeshë  
si dikur fmi.

O, e kërkoj hanën,  
m'sa me 'i gjysë zanit  
me i folun hijeve, që më rrethojnë,  
por mbi sy m'asht ndé tyntaja.  
Ndjeva se më murmurojnë:  
«Eja n'Shkodër, si kur fmi,  
e prep prej zallit  
ke me pa hanën kah çohet prej malit. —  
— Ikën kush'di — përgjegja — sa prendvera  
e sa stuhi shpirtin tim ma rrenuen  
sa tash s'përtrihen stint, që dikur m'gzuen!

1939

---

## ANDRRIME FIORENTINE

*Kushtue F. N.*

**M**bi t'udh's asphalt, që gjarpnon gjatë lumi 1)  
pushon ndoi dritë e zbetë.  
E drita hijen teme n'kalldram tretë.  
E ti o Mik kah hecë me mue  
ma shkelë hijen pa u kujtue.  
Kshtu shpirti i jem i shuemi 2)  
plagoset nga fjal't tueja.  
Ti më pëshperitë,  
e zani t'humbet me t'Arnit zhumburë: 3)  
(A t'bjen nër mend? Dikur...)>  
E mue më ngjallen kujtime pa pritë.  
Androjt të Kleydës 4) sye,  
si dy hije qiellore.  
E si n'vegim e shoh Jolen 5) me tye,

---

1) Gjatë lumi = gjatë lumit Arno.

2) i shuemi = i mjeri.

3) zhumbur-i = zhurma e ujit të lumit

4-5) Kleyde e Jole = emra vajzash italiane.



vashën me krrela t'zez  
si t'landve danga n'Kashinë <sup>1)</sup> atje poshtë.

Un s'pritem pa të pyetë:

«Vall, përse u zhdukën andrrat kaq meiherë?»

Por ti ma s'flet.

Shikon sht'pijat, si kulla mesjetare  
edhe dëgjon kumbonën kah gërset, <sup>2)</sup>

atje larg, në një torre <sup>3)</sup> qindvjeçare.

Shungllon zani si një ankim,

që rrshqet mbi buzë t'mjerë:

«Vall, përse u zhdukkan andrrat kaq meiherë?»

Më pyetë tash tanë trishtim.

Por fjala e jote veshin më përkëdhelë,

si jeh që vjen tu'u shkri

n't' heshtueshmën melodi,

që ty e mue na falë nata fiorentine.

Fjal't tash vdesin mbi buzë tona.

E vijojmë bashkë me shetitë

e veç n'asfalt ndiejm kundrat <sup>4)</sup> tue gërsitë.

Firence 1940.

---

1) Kashinë = Parku i madh i Firencës.

2) gërset = kërcet. Këtu i tingujt e kumbonës.

3) torre = kullë.

4) kundrat = këpucët.

## ZANE STUHISH

(Vdekja e dashunis)

**K**ur mundohem në shpirt me t'depërtue,  
më dukesh vashë, sikur natë plot mshehsi,  
Si natë që trembë edhe joshë me butsi. <sup>1)</sup>  
Dritat e shpirtit tand <sup>2)</sup>  
m'bajnë me u turbullue,  
sikur hyjt n'mbramje <sup>3)</sup> që në qiellë vezllojnë  
m'bahet se m'përpijnë,  
kah shkputen qielle e n'ajri vallëzojnë.  
Kshtu shpirti i jot, m'rërmben ashtu meiherë  
e m'shpjen n'lamije, mbushë me frymë mshehsije  
ku m'shuhen andrrat  
e ndiej nër dej vdekjen e nji dashunije.

- 1) Këto tri vargje në stesurën e parë tingllonin kështu:  
Kur mundohem në shpirt me t'depertue  
më dukesh vashë si nata plot mshehsi,  
mshehsi, që m'dehin unji.  
— joshë = me e thirrë me ambëlsi.
- 2) Ky varg në stesurën e parë tingllonte kështu:  
Humneret, që t'shoh n'shpirtë.
- 3) Kjo fjalë ishte: «natën» e vargu tingllonte kështu:  
sikur yjt natën që në qiellë vallzojnë.

Pëlhurën plot vegime  
 ma shkyen, o vashë<sup>1)</sup>, pa mëshirë.  
 E pra qysh n'fmini ma t'parë  
 t'kërkova me dëshirë,  
 pse malli zemrën m'kishte dalldisë mbarë.  
 Androva nji vashë,  
 me sy, si dy copë qielle  
 e me buzë t'njoma, që s'dijnë veç me dashë.  
 Andrrat fminore m'lindën ftyrën tande.  
 E kështu ngjati për sa e sa motmote  
 e dita-ditës me ngjyrë e gjurmë t're  
 m'dukej ftyra e jote.  
 Me t'tillë vegim hyna n'jetë djaloshare  
 e mora udhën mërgimtare<sup>2)</sup>.  
 M'ihuej tash vashë:  
 pse n'mërgim mujta me ndeshë  
 syt e azurrte<sup>3)</sup>, që krejt m'patën shastisë?  
 e pse nisën me më qeshë?  
 Qysh at ditë, syt m'kan molisë  
 e jam bjerrë n'sy t'tue!

---

1) Në vend të fj. «o vashë», përpara ishte e shkruar «Kleydë» porse poeti, kur e pregatiti poezinë për botim e korigjoi, duke dashur ta zhduki emrin, sepse atëherë timbri personal i poezisë dilte fare sheshit.

2) Mbas këtij vargu janë dy vargje që poeti i shoi kur pregatiti stesuren që botoi e që ne po i riprodhojmë:

«Në botë se t'gjeshe, dyshoshe mirfillë,  
 por n'gjumë dehse t'lmoshe, se m'kishte ande.»

3) Ky varg tingëllonte:

«syt e azurrte, që dikur m'patën shastisë.»  
 E azurrte-italianizëm: e kaltërt.

..... 1)

E u shkrimë bashkë me shoqishojnë,  
si dy-tri dru n'votër një flakë përftojnë.  
Por një ditë u shkëputa syve tue 2)  
e n'shpiert mjerimi 3) nisi m'u shpeshtue,  
M'thuej vashë, se tash kam nevojë:  
përse kaq shpejt zbehen andrrat mbi botë?  
M'thuej... Syt e mytun në gjith at trishtim 4)  
S'm'lanë me çelë gojë<sup>5)</sup>,  
mbasi ata m'përgjegjin pa u kujtue.

---

1) Ky varg është prishur më vonë, sepse poeti kur e dërgoi në shtyp s'donte të hapesh tepër me zbulime të jetës tij private. Vargu i prishun me një vijë sipër, tingllon kështu:

«E ti thae se je bjerrë në sy të mi.»

2) Ndarja në mes tyre s'pati asnjë motiv. Ata u larguan sepse e kuptuan se asgjë e mirë, asgjë e qëndrueshme s'mund ndërtohej nga dashuria e tyre: të dy ishin të prekur nga tuberkulozi.

3) fj. mjerimi, është stesura e tretë: herën e parë ishte shkruar «tallazi», pastaj «trishtimi» e së treti «mjerimi», në vend të fj. zbehen, ishte shkruar përpara «shuehen.»

4) Ky varg përpara ish kështu:

«M'thuej... Por syt tue të mbushun plot trishtim.»

5) Edhe ky varg është korigjuar sipër. Ishte kështu:

«S'm'lanë me çelë prap gojë.»

O vashë ndiej mall për fytyrën që bora 1)  
e ndjej përqethje për shka kam për t'bjerrë.  
Drue se shpresat tjetër s'janë  
veç flakë n'shpiritin tonë,  
flakë që një mbas një fiken heret-vonë  
e mbesim n'terr si në një natë nandori.  
Shko malli i dashunis,  
shuehet ma vonë ndoshta, malli i gjithësis, 2)  
e shpirti mbetë i ftohtë, si muzg dhatori, 3)

Shkodër 1941. —

- 
- 1) Fytyrën që bora = fytyrën që humba.
  - 2) Në vend të fj. gjithësisë — ishte —«poezisë».
  - 3) Ishte: e mandej mbetë shpirti, si muzg dhatori.

---

---

## DRITË TË MSHEHUNA

**D**eri dej t'imt kërktoj n't'mundafshat durë <sup>1)</sup>  
m'ngjajnë si pej ngjyrë qielle lshue n'ndoi pëlhurë,  
N'trupin tand përherë dridh's dej t'ri kërktoj  
sepse dejt tue, nga vapa janë harlisë.  
E ndiej se jeta vlon, si un dëshroj,  
E kryet pshtes mbi flokë të zi,  
e ti mbi flokët e mi.

Por syt një tis pendimi përshkon  
e shpejt qerpik't lodja <sup>2)</sup> pa dashë i njomë  
n'sa ti qepallën me qepallë ngatrron.

M'qase, me buzë plot pshertimë,  
m'qase, si me m'lypun ndihmë.  
E ftyra jote krejtsisht m'ka shastisë  
e një tubë dufesh n'shpirt me lindë m'kan' nisë  
e hij' e tmer na pshtjellin n'kët muzg t'ngrimë.  
.....

---

1) n't'mundafshata durë = duar të mëndafshata, duar të  
holla.

2) lodja = loti.

Fike dritën, se terri — thae — m'pëlqen:  
se kur mkatnohet, vjen mbi shpirt tim terri,  
pse mkati asht terr, e mkati po shpërthen.  
T'shuhet drita n'dhomën tonë,  
se ndoshta mbas nji çasi... tepër vonë...

E n'dhomë terrinat lindën me nji herë,  
e m'buzë pshertimat n'gjamë të mjerë u shndruen  
n'sa m'qasshe, e s'dishe veç me qasë përherë.  
M'thuej, e shkreta mori vashë,  
m'thuej: «ashtë vallë mkat me dashë?»

.....

Pëshpirtshe: «Ndal dritën, që ban me pa».  
Po a din, se bota e njerzimi tashma  
dritën ka frikë e terrin ka përçafë? 1)  
A e din, se terri kaplloi, 2)  
shpirtin kobi na e mbuloi?

Kshtu si në dhomë, n'botë hijet kan zotnue  
e s'dim prendimin me e dallue nga agu 3)  
e n'shpirt pa mshirë stuhija asht' tue zhaurrue 4).  
nuk ka dritë, (mikeshë dëgjon?).  
N'botë si ktu drita mungon.  
Shkodër 1941. —

---

1) ka përçafë = ka përçafuar.

2) kaplloi = mbuloi fare.

3) ag-u = agimi.

4) tue zhaurue = duke bërë zhurmë të madhe.

---

## VASHË E PANJOHTUN

**Q**epallat m'janë randue,  
e dridhet si dejt n'mallin dashunuer. . .  
janë lodhë e ma ty vashë s'donë me t'shikue.  
Por un gjithnji i çeli  
e atherë rrahin pa pushue,  
Fytyra e jote endë me terr dhe dritë  
asht mytë<sup>1)</sup> n'muzgun vjeshtuer.  
E ftyra m'duket nji det plot mshehtsi,  
qi me dëshirë më mbushën shpirtin pa pritë.  
E syt e mi shkojnë meiherë në syt tu,  
e syni i jot asht mbushë plot trishtim,  
si mbushë asht muzgu e njerzit ktu për rreth.  
Por njeni sy nga hija t'asht mertisë  
e un due me e zbulue,  
pse n'shpirtin tim  
ka lindë malli për syt tu.

---

1) mytë = mbytë.



Hana tash shkrepri mbi qepalla t'gjatë  
e endi viza mu n'mollza t'faqes s'zbetë,  
hije, qi krijojnë gardhin ndalimtarë,  
pse tash nuk mundem ma  
asnjenin sy me pa.

Nji kind buzet të dridhet tash e parë,  
më thotë zemra dishka flet  
për mue, me shoqen përbri.

A thue buzët tueja mshehun nga e till' hije,  
veç m'bajnë me mendue.

M'thuej vashë: pse s'asht ditë  
me pa shka due me pa?

O përse s'asht natë e pa kurrnji dritë,<sup>1)</sup>  
e mos të shoh ftyrën, q'asht tue m'tundue?

Por syt s't'i dajë o vashë,  
pse m'përkujton jetën qysh n'fmimi t'parë:  
gjithkund kah heci ndeshi veç mshehëtsi,  
por vijoj udhën me sy andërrtarë.

Kështu vashë,  
fytyra e jote forca t'reja m'ngjallë  
pse m'bahet se vroj Misterin mu n'ballë.

Shkodër 1941. —

---

1) me tundue = shtytje për të mëkatuar.

---

## MENGJESE SHNJERGJASH \*

**N**ë buzë t'kuqe si agimi  
i Majit dridhej gëzimi <sup>1)</sup>  
kur Vasha me flokë ari  
n'derë niste lule t'vari.  
Simjet por, duert't e bardha  
mermer i ngrini mardha. <sup>2)</sup>  
Njimijë duerë varzash tjera  
vendojnë lule te dera,  
si Shkodra e ka zakon; <sup>3)</sup>  
por ti në vorr pushon.  
Kot rrezet e prarueme  
n'qytet zgjojnë valle t'lume.

---

1) dridhej gëzimi — në stesurën e parë ishte: rrshqitte gëzimi.

2) mardha = ngrica.

3) Bri këtij vargu e tjetrit që ndjek, janë dy vargje:

«por n'shpin time prendverë  
nuk çeli si përherë.»

Vallzojn' kot kumbonaret  
e grishin t'çohen fare,  
qytetast, qi janë n'gjumë,  
pse nën rrasë s'jehon kumbë.<sup>1)</sup>  
Gazmend gjithkahë përtrihet,  
n'çinar<sup>2)</sup> der, cijim ndihet,  
n'sa dyert mbushen n'blerime  
por Lil,<sup>3)</sup> për ty s'ka gzime,  
Kumbona shpresë nuk t'njallë,  
dhe zemrës sime t'gjallë,  
blerime n'dyer tue pa  
i kndon. Kohët nuk kthejn ma.

N'qytet veç kangë ndihet.  
Por s'mundem ma me andrue  
mos hylli pse m'u shue<sup>4)</sup>  
...m'ka prendue<sup>5)</sup>.

---

1) Kumbë: kumbim, jeh, — gjënim kumbonë.

2) çinar-i: rrap shekullor, që gjindet ndër vorrezat e Shkodrës, strehë qindra çerdhesh zogjsh këngëtarë — kontrast me vendin e vdekjes, të vajit.

3) Emri i një vajze me të cilën poeti u rrit bashkë.

4) Në mes këtij vargu gjindet fjala «Zot», por është e prishun.

5) Këto katër vargje pa kuptim tregojnë se poezia nuk u përfundua, sepse ankimi «ylli pse m'u shue» nuk e zgjidh idenë.

## PRENDIMI I ANDRRIMEVE

**Z**hurma e karrove  
meket mbi qelqe t'bardh të dhomës sime,  
nga sheshi ktu tue ardhë.  
E mbrend' s'dridhet n'ajri  
as ma e vogla valë.  
E mue andrrimet më bulojnë  
e syt me ndriza <sup>1)</sup> hijesh m'avullojnë.  
Vegime m'lejnë atherë  
në kët mjesditë zhegore.  
E shoh, shka s'pashë kurr në jetë,  
ndiej shka s'ndjeva kurr një herë:  
vasha me buzë n't'cillat shpërthyen burbuqet,  
shtëpija të ndërtoeme  
n'rubina, si mollza fytyrash vashnore,  
ku rrshqet gazi, si 'i mij' gush bilbilash.

---

1) ndriza = shpërgej. Këtu: driza pan syvet.

Por një za nga fundi i shpirtit më trandë<sup>1)</sup>.  
Shkyhet tisi<sup>2)</sup> i vegimevet t'krijueme.  
Me një herë zhduken lulishtat prrallzore  
si hyjt, që shkputen në një natë verore.  
Zani më grishë me jetue  
e jo me afrue qepallen me qepallë  
e me ndejë tue andrrue.  
Më thotë zani: me i kndue jetës,  
më thotë zani: me i kndue kohës.  
më thotë zani: kndoj s'vërtetës,<sup>3)</sup>

Shkodër 1941. —

---

1) më trandë = më trondit.

2) tisi = perde e hollë.

## PRANË LUFTËS

**D**eri ktu n'mal të thatë tretë kumbimi,  
që bajnë grat kah bisedojnë.  
E n'qiellë fluturakët, <sup>1)</sup> si tubë dallndyshash,  
përshekohen e gjimojnë.  
Ullijt e zbetë lkunden  
prej er's, që zbret nga mali.  
Përqethen <sup>2)</sup> dejt e gjethve, që përkunden.  
M'duken si me bisedue.  
M'pyesin: «Ç'ka lum djali,  
ç'ka mali që gjimon,  
si gjimue s'ka tash sa vjet?»  
E mue, që një et  
malli m'ka përvlue  
me çelë portat e zemrës,  
nisi dy fjalë me i shndrrue:

---

1) Fluturaket = aeroplanat, neologjizëm e kohës.

2) Përqethen e rënqethen.

«Ka fillue lufta,  
sepse nga zjarmi i vjetër,  
n'zemrat njerzore veç hi ka mbetë  
si rrenojet<sup>1)</sup> n'qytet mijvjeçare.  
E tash një flakë tjetër  
kërkojnë shpirtënt të dëshruem për dritë».  
E flas e flas, n'sa syt i kam burgue,  
për nën qepalla t'dehuna n'shkëlqim,  
qepallat, si pyllë plepash t'pambarim.  
N'gjysa-terr fytyra m'lindin  
me ball tanë zagna<sup>2)</sup>, si toka ktu n'arë,  
djelmni tanë vuejtje, por me fitim n'ball.  
E pranë një zhurmë shpërthen,  
Si t'ishin malet për rreth tu' u rrenue.  
E n'qiellë ndezën flakë meiherë,  
që m'duken varrë t'përgjakuna  
mbi gjoksa të mjerë.

Sheldi 1941.

---

1) Rrenojet = gërmadhat.

2) Zagna = kurrizet e hullive të arave.

## HYJT MBI GREMINË

**M**bi buzë kang't pada m'buçisin,  
n'sa gjamë luftar'sh s'plaguem  
n'ajri plot flakë gjimojnë.  
E zajet që m'lamiye t'vdek's ushtojnë  
vërehojnë në dhomën time,  
ku bulojnë një mbas një njimij' andrrime.  
E brima <sup>1)</sup> t'ndryshme m'lindin n'dhomë meiherë  
e ftyra t'ndryshme m'lindin n'dhomë meiherë,  
ftyra t'murrme, zaje që kërcnojnë.  
Hijet m'murmurojnë:  
«Ende vallet s't'janë shuem?  
O, si t'kndon zemra, — m'pyesin një zani —  
n'sa n'botë s'ndiehet veç vajë,  
e nga gjoksat tonë, gjaku derdhet rrakajë?»  
E trandë shpirti e m'zhduken kang't nga buza  
m'duket se krejt jeta nisë me u rrenue,  
njashtu si nga tërmeti  
muret e vjetra, shkojnë tue u zhgatrrue. <sup>2)</sup>

1) brima = britma.

2) shgatrrue = shkatrrue.



Por nër buzë t'mija prap një fjalë u ngjall:  
«O, m'leni hije — gjegja me 'i gjysë zani —  
m'leni t'vijoje me mall,  
pse kam humbë n'shtojë udhën e vërtetë.  
Un s'daj shtigjet, që rraha gjithherë,  
s'shoh ma qiellen, që ndritte ma parë.  
Gjithshka ka ndrrue:  
Mbi botë thellimi ka bulue.  
Prandej me kangë dëshroj me i sherue varrët.  
Kanga m'ngjallë rininë,  
pse vargjet lenojn<sup>1)</sup> dhimat,  
kah shndrisin shpirtin, si hyj mbi greminë».

Firence 1940.

---

3) lenojnë == lehtësojnë.

---

---

## UDHASH SË VETMUEME \*

**N**ë qiellë t'qartë hyjt shetisin plot mshehtsi,  
e un këtu poshtë shetis.  
Kamba, shpesh herë, n'gropa e gur,  
udhash që baris,  
më ndalet unji. <sup>1)</sup>  
Thotë shpirti: dritë dëshroj  
për me njohtë shtigjet, që jam kah përshkoj.  
Atherë lindin mendime.  
E n'shpirtin tim rrahin njimij dyshime,  
por hapi im nuk ndalet  
sepse vijoj prap pa dijtë kah me shkue,  
ashtu si qorri, qi s'ka kush m'e udhzue. <sup>2)</sup>

Por m'flet një za ner udha të vetmueme:  
— Strukem nër qoshe portash e baj dritë  
balushë <sup>3)</sup> e zbetë un jam,  
por luftë me terrin baj dita për ditë. —  
Kështu m'flet xhixhilloja.  
Xhixhilloja m'flet kështu!  
Hapin ndali shpejt atherë  
për me gjetë dritën, që dëshroj nga herë.

---

1) unji = e tëra.

2) m'e udhzue = me e udhëheq.

3) balushe = njollë e bardhë me një sfond të zi.

Por ças n'ças, pa pritë  
nër syt e sajë fiket e mekta dritë.  
Atëherë kaloj plot tallje dhe mëni,  
se kam nevojë për dritë që s'ka mbarim.

E ndjeva një za, tue zbritë me ambëlsi;  
hyjt pëshpërisin nga qiella plot shkëlqim;  
«Na jem shumë hyj ktej pari,  
pra shtrije dorën o shpirt dyshimtar  
e grabit hyllin me fytyrë si ari.

E shikoj qiellen. Asht qiella tepër larg!  
N'shpirit m'rreh një mëni.  
M'përshkohet një përbuzje në sy t'mi.  
e mbi buzë gazi tallës me shpërthen  
«Due t'shtrij dorën, hyj t'ju grabis  
e të ju shkryej një nga një n'pluhun udhash  
mbi të cilat vetmatarë qyshkur shetis.  
Due t'ju coptoj e dritën due t'ju fiku  
ju që dyshime nisët me m'krijue,  
ç'nga fmini e parë e s'desht kurr me m'zditue»<sup>1)</sup>  
Shpirti m'flet përsri: «Dritë dëshroj  
për me njohtë shtigjet, që tash përshkoj.»

Por një za qortues m'flet me kumbim t'ri  
e ma plasë shpirtin unji:  
«Jashtë dritën kot kërkon, njeri i mjerë,  
Sielli syt, kërkë n'shpiritin tand një herë!»  
Shkodër 1941. —

---

1) me m'zditue = me m'ndriçue.

## NATË SHTRËGLLASH

**L**etas luen hana sonte pemët e mdhaja  
e i rravizon 1) mbi 2) tokë gemat të tanë, me mija  
e mbi tokë varzat shkelin hijet,  
përftojnë 3) hije me shtat të gjatë  
nersa lkundin të hollat ijet  
nën mand 4) që flladi gjethësh dridhës don m'e shkundë  
mbi moshë të re, në shtregull 5) tuj u përkundë.

E vallet vlojnë me zane të kumbueshme,  
kndo një i vetëm, përcjell zane të bashkueshme,  
hapet zemra me ndiesi:  
fletët, 'si lili çilë n'agim  
sa e puthë rrezja, plot ngrofsi.  
Shprazin dashtninë të rit prej zemrash të veta  
nër shtreglla, veç tu'u pa, prej dritash së zbeta.

Mbesin shtang të bardhët pleq, 6) tuj ndie, tuj këndue,  
n'sa përkujtojnë, të dikurshmet stinë kalue  
me lojë dhe t'ambla valle  
në të Shnjergjit mramje nëpër shtreglla,

1) i rravizon = i vizaton.

2) Parafjalën *mbi* poeti në dorëshkrimin e shkruan  
simbas trajtës arkaike *mbë*.

3) përftojnë hije = krijojnë hije.

4) mand-i = man, mën.

5) Shtregull ose shrregull = shilars, kolovajzë.

6) të bardhët pleq = pleqët e thinjur.

në të darsmes net, me dashtni të madhe,  
pikshoshin<sup>1)</sup> vashat, në mahramë<sup>2)</sup> gjysë ftyrë mlue  
knaqun n'vegim, të rit pa nisin m'u mjerue. . .

Por megjithkta në sye tu'u shikjue vijoje  
të rit, të veta' valle e shka u thot zemra kndojnë;  
mbushet shpirti si prandvera  
me nji shpresë t'ambël qi i gzon.  
Shpresa në çdo zemër banë<sup>3)</sup> era;  
e qeshë dashtnori e vasha edhe ajo qeshë  
nërsa përkundin shoqishojnë në degë pa e ndeshë.

Shpërndahen dridhje, në të vendit tonë hapsinë:  
Iliret kodra, të reja Ilire ndiejn  
e shtreglla e valle të hershme  
Teuta qi këndoi dikur,  
tue kndue varzat e ndershme  
të qytetit të Shkodrës, qi nuk flenë der vonë  
tue e pritë më valle si gjithmonë.

Por lodhen, n'sa nisë vendi të kthej i qetë,  
e ndihet gjethi gjethin tu' e përshndetë  
dahen<sup>4)</sup> njerzt, mejnë vallet të tana.  
Veç s'rrin shumë në gjumë qyteti:  
grishë kumbona në katër ana,  
banorët m'u zgjue 'dhe lule vile e tjera  
si mbas zakonit, prep me vjerrë<sup>5)</sup> te dera.

1936

---

1) pikshoshin vashat = këtu; spikatnin n'errësira ftyrë  
tyrat e vashave.

2) mahramë-a = një lloj sharpi që mbanin vajzat në  
Shkodër.

3) banë era = mban era.

4) dahen = shpërndahen.

5) prep me vjerrë = prap, sërish me varë.

## KANGA E POETIT

**N**'qiell dy-tre hyj shndrisin t'zbetë  
e duken si sy të venitun vashash  
që kan sprovue humbjen e dashnis s'parë.  
Nper ajri ndoi jone <sup>1)</sup> tretë:  
dikush këndon me një za mallngjimitar.  
Duket se nata s'lëvizë, as s'merr frymë  
kah rrin e prigjon.  
E qiella e bardhë, si qumsht i pa përlyem  
nga snalti shikon.  
Kjo qetsi zbret në shpirtë t'kangatarit  
e i zblon një mall t'ri deri tash i ndryem,  
pse toka e qiella kan heshtë para fjal's s'tij.  
Buzët i dridhen gjithherë me hov t'ri,  
pse kangatari n'zemër ndryen  
gëzimet e bot's mbarë  
e dhimat e bot's mbarë.

. . . . .

---

1) ndoi jone = ndonjë tingull muzikor.

## SHËNIME

Vjershat që përmbliohen në këtë vëllim janë nxjerrë nga dorëshkrimet që ka lënë poeti. Ne e pamë të udhës që nga 24 vjershat të fusim në përmbledhje vetëm 19. Ato që nuk përfshihen këtu, i përkasin periudhës së parë të krijimtarisë së poetit ose kanë të bëjnë me ndonjë moment jo të shëndoshë dhe si të tilla i lamë jashtë.

Duke pasur parasysh se Pali ka shkruar me një gjuhë plot idioma, ne vumë disa shpjegime fjalësh për masën e gjërë të lexuesve dhe bëmë vetëm disa ndryshime përsa i përket orthografisë.

1. Përemrat pronorë tim, tonë e tjerë i vumë pa apostrof.

2. Disa fjalë që në qytetin e Shkodrës shqiptohen me *ll* në vend me *dh* e anasjelltas ne i rregulluam, si *drillje* — *dridhje* ose e kundërta *sjedhje* — *sjellje* e tjera.

3. Parafjalët *porse*, *përse*, *sikur*, e tjera, që poeti i shkruante veças, ne i kemi bashkuar.

4. Diftongun *ue* në disa raste e kemi hequr si shuehen — shuhen, dikuer — dikur e tjera.

5. Kemi bërë disa ndryshime në disa fjalë si në vënd të:

sbrit = zbrit

shduk = zhduk

zhegjetë = shëgjetë

6. Kemi hequr disa herë ë, kur ajo është vënë pa qenë nevoja.

7. Kemi rregulluar edhe disa nga inkoseguencat e vetë orthografisë së poetit.

### *Zëmër andërrtare*

Është e pabotuar. Poezi simbolike: poeti është murgu, haxhiu, këngëtari që ndjek karvanet e njerzimit të gëzuar. Por dëshira t'u flasi masave, të dëgjohet nga turma, ngelë vetëm ëndër që i zhduket menjëherë, si tymi i një kamini të vogël në hapsirën e pamasë të qiellit.

### *Bisedë me qytetin tim*

Kjo poezi është e vetmja e vitit 1935 që kemi. Tregon vitin më kritik të jetës së poetit, vitin e papunsisë, vitin kur «ju zhduk rinija», siç e thotë ai vetë, sepse, megjithse në moshën e ëndrimeve, vihet përpara problemeve për të përballuar jetën. Kronologjikisht është e para ndër poezitë e përmbledhjes «Bisedë me vetvedi».

### *Natë shkodrane*

Poezi gjithë mall, shkruar në dhe të huaj për atdheun e largët. Në dukje një poezi pejzazhi, por indirekt tregon realitetin e jetës së hidhur që kalonte Shqipëria e Shkodra gjatë okupacionit fashist.

### *Vjeshtë.*

Kjo lirikë përshkruan vjeshtën, peizazhin shkodran, ndoshta një përshkrim të largët të jetës sonë nën thundrën fashiste.



### *Djepi i Vorfën.*

Kjo është e para lirikë në fillimet poetike t'autorit me një temë konkrete nga jeta. Këtu jepet një kuadër i mjerimit të kohës së regjimit feudo-borgjez të Zogut. Nëna ka humbur çdo shpresë për t'arthmen e foshnjës që fillon jetën e dënuar të heqi zi qysh në djep. Veç duhet nënvizuar se lirika mbyllet me një ton optimist, kur thotë se «foshnja qesh».

### *Kangë gungallash.*

Në këtë vjershë jepet atmosfera e një qyteti shqiptar që jeton muajët e parë t'okupacionit fashist. Çdo gjë duket sikur heshtë dhe me këtë heshtje dëgjohet vetëm kënga e gjinkallës. Edhe kënga e poetit i ngjan këngës së gjinkallës: këndon, por askush s'e dëgjon.

### *Vegim mërgimesh.*

Poeti dhe në këtë vjershë duke qënë larg i këndon mallit për atdhe, mallit për Shkodrën.

### *Muzg mërgimi.*

Poeti është në mërgim, ka mall për vendlindjen; hijet e fëminisë i flasin për muzgjet shkodrane, por fminija ka ikur përgjithënjë.

### *Andrrime fiorentine.*

Kushtuar mikut të tij të ngushtë F. Ndocaj. Këtë poezi e kemi në katër variante. Ky që po botojmë është varianti i katërt.

Kjo vjershë shpreh dashurinë e poetit për shokun e tij dhe nostalgjinë e kohës që kanë kaluar bashkë. Stesura e parë e kësaj poezije ka si titull GJAT'ARNI — udhët e brigjeve të lumit Arno që ndanë qytetin e Firences në dy pjesë e gjatë të cilëve dy shokët e kishin zakon të shëtisnin natën.

#### *Zanë stuhish. (Vdekja e dashunis).*

Kjo është më e bukura e vjershave erotike të poetit. Poezi të cilën ja frymzoi Kleyde, shoqja e fakultetit të letërsisë në Firence, një siqiljane e bukur që poeti e dashuroi me zjarrin e dashurisë së parë e të fundit. Është shkruar pas një viti kur çdo gjë kish marrë fund në mes dy dashnorëve, prandaj edhe titulli i parë i kësaj poezije, që «Vdekja e dashunis». Poeti pastaj, kur e korigjoi për ta dërguar në shtyp, e ndërroi titullin: «Zanë stuhish» — titull më i përshtatur — sepse dashuria e tyre edhe pse s'vazhdonte më, s'kish vdekur as në zëmër të poetit, as të Kleydes. Dashuria e vërtetë nuk vdes kurrë. Atë e mundonte më shumë stuhia e ndjenjave që i zgjonte kujtimi i kësaj dashurie fatkeqe.

#### *Dritë të mshehuna.*

Është një nga poezitë erotike të Palit ku jepet me nuanca delikate një moment ekstazë dashurije.

#### *Vashë e panjohtun.*

Në këtë vjershë vihet re përpjekja e poetit për të bërë analizën psikologjike; kërkon të lexojë në sytë e vashës mendimet dhe dëshirat e saj.

### *Mëngjese shnjergjash.*

Motivi i kangës është marrë nga zakoni që kanë vashat shkodrane që ditën e Shën Gjergjit, «krushku i prandverës», të zgjohen me natë e të varin lule ose degë të lulëzuara pemësh ose blerime në dyert e atyre që dashurojnë. E çdo vashë do, që të jetë e para të vari lulet sepse me këtë mendon se ka bërë për vehte zëmëren e dashnorit. Këtë motiv, siç e pamë, poeti e shtrin më gjërë në vjershën «Natë shtregllash».

### *Prendimi i andrrimeve.*

Është vjersha e Palit, që ka përmbajtjen më të shëndoshë. Ai fillon e kupton se cila është detyra e poetit në kohën e tij dhe mundohet të kalojë nga bota e ëndrrave në jetën reale.

### *Pranë luftës.*

Në kohën e luftës së dytë botërore, nga kërcënimi i një bombardimi ajror, një pjesë e popullsisë shkodrane e la qytetin e iku fshatrave. Poeti, duke qenë në mes asaj turme s'ka me kë të flasi dhe flet me ullinjt' e fshatit. Luftën ai e paraqet si pasojë të dekadencës, të kulturës perëndimore që në shek. XX ka varfëruar shpirtat.

### *Hyjt mbi greminë.*

Hyjt janë rinia që rron mbi jetën — greminë — në frontet e luftës dytë botnore.

Poetit i kanë lindur këngët në një kohë vajesh, atij i duket tradhti ndaj shokëve që mbesin llogoresh, viktima të

luftëdashësve; të këndojë në këtë kohë kur s'të dëgjon veshi, veç gjëmë lufte.

Këto viktima, formë hijesh me fytyra të nxira nga tmerri, kërcënuese kundra poetit që këndon në një kohë kur ata vdesin, japin kuadrin e kohës që s'është kohë këngësh.

### *Udhash së vetmueme.*

Kjo është një nga vjershat më karakteristike që dëshmon se poeti e ndjente veten të vetmuar, se ai kërkonte rrugë të reja, por prap këto rrugë ishin t'errta. Ai kërkonte rrugë me dritë dhe koha nuk ja diktonte. Jemi në fillimin e okupacionit fashist. Sa kontratë i madh është ky kuadër i errët i gjëndjes së intelektualëve t'asaj kohe, me rrugët e ndritura që i janë hapur intelektualëve tanë sot.

### *Natë Shtregllash*

Kjo lirikë e merr frymzimin nga motivet e këngëve popullore të shtregullave që festoheshin me vallet tipike pranverore:

«Ulu mal sa të dalih hana  
sa të na bajnë rrexe për mbrama,  
sa të na shkojnë vashat për ujë,  
ndalu vashë e na nep ujë....

Por nga motivi popullor poeti del në një paraqitje të stërhollët — çdo nuancë e natyrës atë e prek, i tërheq vëmëndjen.

Në Shkodër ka qënë zakon që në mes të dy festave të Shën Gjergjit (të voglit dhe të madhit), për afro dy javë çdo natë, nga muzgu i mbrëmjes e deri n'orët e vona të natës, njerzit e një lagje mblidheshin nëpër kopshte dhe

festonin vallet e shtregullave. Të rinjtë këndonin duke u lëkundur nëpër shilarse, ndërsa të vjetrit pinin dhe kujtonin të kaluarën.

### *Kanga e poetit*

Nuk dijmë se kur e ka shkruar poeti. Dimë vetëm se kjo është vjersha e fundit në përmbledhjen «Bisedë me vetvedin» që autori e gatiti me gjallje të tij. Këtu kemi vetëm fillimin e vjershës, kurse pjesën tjetër poeti në ndonjë rast dëshpërimi dhe pabesije në vetvete e grisi. Këtë e ka bërë ose sepse vjersha nuk i u duk e përkryer ose sepse çfaqte në të haptas mendimin mbi misionin e vërtetë të poetit në shoqërinë e kohës.

## TRYEZA E LËNDËS

	Faqe
— Gaspër Pali (1916-1942) .....	5
Zemër anderrtare .....	17
Bisedë me qytetin tim .....	19
Natë shkodrane .....	21
Vjeshtë .....	23
Djepi i vorfën .....	25
Kangë gungallash .....	27
Vegim mërgimesh .....	29
Muzgë mërgimi .....	31
Andrrime fiorentine .....	33
Zane stuhish .....	35
Dritë të mshehuna .....	39
Vashë e panjohtun .....	41
Mëngjese Shnjergjash .....	43
Prendimi i andrrimeve .....	45
Pranë luftës .....	47
Hyjt mbi greminë .....	49
Udhash së vetmueme .....	51
Natë shtregllash .....	53
Kanga e poetit .....	55
<i>Shënime</i> .....	59